

Informacionet mbi festën e fenerëve

Të dashur prindër,

më ____ nëntor festojmë në Kita Festën e Fenerëve. Rasti është Dita e Shën Martinit, një ditë përkujtimore e krishterë, më 11 nëntor, e cila i përket ushtarit Martin nga Tours, i njohur si Shën Martini. Ai lindi rreth vitit 316 pas Krishtit dhe origjinën e kishte nga Hungaria e sotme.

Historia tregon se ushtari Martin kalëroi pranë një lypsari në një natë të ftohtë dimri. Ai ishte i veshur vetëm me ca leckë në trup dhe i kërkoi ushtarit lëmshë. Por Martini nuk kishte asgjë me vete, përveç armës, kështu që ai mori shpatën, ndau gunën e tij dhe gjysmën ia dha lypsarit.

Ne mendojmë se ajo që bëri Martin është e mrekullueshme dhe që ai me vetëmohim e ndihmoi lypësin. Me siguri tani që hoqi gjysmën e gunës, ai kishte të ftohtë. Meqenëse nuk duam t'i harrojmë veprat e tij të mira, e festojmë këtë ditë me anën e Festës së Fenerëve, pasi thuhet se edhe Martini ka pasur një fener me vete atë ditë. Në Festën e Fenerëve ecim nëpër rrugë me fenerë në duar, këndojmë dhe kujtojmë, se si Martini e ndihmoi njeriun e varfër.

Mendojmë gjithashtu edhe për ata që sot nuk janë mirë, që nuk kanë aq sa ne, por edhe sa e rëndësishme është të ndajmë.

Urimet më të mira

Drejtuesit e Kita-s